

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE**  
**“ALFA RROBAQEPSI” SH.P.K.**

Ky statut do të konsiderohet se përfshin dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë, organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot më 17.03.2023,ortakët themelues

- 1- Alda Gjoka,shtetase shqiptare lindur më 13.04.1989,lindur në Kurbnesh,banues në Shullaz ,Laç,mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I95413097Q madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar
- 2- Fred Gjoka,shtetas shqiptar lindur më 05.03.1980,lindur në Xhuxhe,banues në Shullaz,Laç,mbajtës i kartës së identitetit me nr personal I00305068K madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

në përputhje me Ligjin Nr.9901,datë 14.04.2008”Për shoqëritë tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë,miratojnë këtë statut si vijon:

Në këtë Statut:

-“Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare” i ndryshuar

-“Statuti” është ky statut i Shoqërisë

**KREU I**

**Themelimi,Emri,Objekti,Kohëzgjatja**

**Neni 1**

**Data e themelimit,Emri dhe Themeluesit,Selia**

Sot ,më 17.03.2023 ,ne,themeluesit e mësipërm,kemi krijuar një shoqëri me pergjegjësi të kufizuar me emrin tregtar”ALFA RROBAQEPSI” SH.P.K.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm:

Fason, prodhim te veshjeve te ndryshme tekstile per vete dhe per te trete. Perpunim aktiv per llogari te vet dhe per te trete. Import-Eksport te prodhimit te veshjeve te ndryshme per llogari te vet dhe per te trete. Tregtimi dhe perpunimi i veshjeve te ndryshme per vete dhe per te trete (fason) si dhe blerje-shitje te makinerive te pelhures dhe te tekstileve ( Brenda dhe jashte vendit ). Transport Brenda vendit dhe nderkombetar per vete dhe per te trete,

Në funksion të qëllimeve të mësipërme Shoqëria mund të hyjë në tregje dhe operacione të ndryshme,të zotërojë pasuri të luajtshme e të paluajtshme dhe/ose pjesmarrje në shoqëri të tjera tregtare.

**Neni 3**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.

#### Neni 4

##### Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresë: Lagjja nr.3,Nr pasurie 3/601,Zona kadastrale 2364,Laç,Kurbin.

#### Kreu II

#### Kapitali

#### Neni 5

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është 2.000.000(Dymilion)Lekë dhe është i ndarë në 2(dy)kuota .Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

a-Ortaku themelues Alda Gjoka zotërues i nje kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.000 (Njëmilion)Lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë..

b-Ortaku themelues Fred Gjoka zotërues i një kuote me vlerë të përgjithshme 1.000.000 (Njëmilion)Lekë që përbën 50% të kapitalit themeltar të shoqërisë..

Kontributi i ortakëve është në para.

Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotës së tij.

#### Neni 6

##### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet ne para dhe me anë të kontributeve në natyrë,nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që perfaqësojnë.

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

-Kontributit në kapitalin e shoqërisë

-Shitblerjes

-Trashëgimisë

-Dhurimit

Çdo mënyrë tjetër e parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nëpërmjet ortakëve,për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rruge trashëgimie.

### **Kreu III**

#### **Organet vendimmarrëse dhe drejtuese**

##### **Neni 8**

##### **Organi vendimmarrës**

Asambleja e ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

a-Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë

b-Ndryshimet e statutit

c-Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve

d-Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar

e.Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d të kësaj pike.

f.Mbikqyerjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët,përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

g-Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

h.Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit.

i-Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre.

j.Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve.

k.Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

l.Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

m.Shpërndarjen e fitimeve vjetore.

n.Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administrator i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme,e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

##### **Neni 9**

##### **Mënyra e thirrjes sëmbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose,nëse parashikohet nga statute,me njoftim nëpërmjet postës elektronike.Njoftimi me shkresë apo mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin,datën,orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve ,jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni,ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marë vendime ,pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votive, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë në të njëjtin rend dite.

## Neni 11

### Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votimeve të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin dhe shkarkimin e likujduesve të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

## Neni 12

### Përfshirja nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë të tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizik si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i shoqërisë për një mandatë të plotë 5 (pesë) vjeçar emërimi:

Zj. Alda Gjoka, shtetase shqiptare, lindur më 13.04.1989, lindur në Kurbnesh dhe banuese në Shullaz, Laç, mbajtëse e kartës së identitetit me nr. personal I95413097Q, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, pa kufizime në kompetencat e administrimit.

AB:

## **Kreu IV**

### **Viti financiar-ekspertët**

#### **Neni 14**

##### **Viti financiar**

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 janar dhe përfundon në 31 dhjetor. Përfundimisht, viti I parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 dhjetor.

#### **Neni 15**

##### **Ekspertët**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara të cilat është i detyruar që tja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Kreu 5**

### **Prishja –riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni 16**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të asamblesë së ortakëve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përpythje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2017; me vendim të gjykatës.

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në cdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër". Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave të likuidimit në gjëndjen e aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortakët. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve. Brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund ti drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 17**

##### **Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përpythje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën VIII të ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 18**

##### **Baza ligjore**

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e tij në përpythje të plotë me këtë statut, dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Ky akt u hartua në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua,u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:

**ORTAKËT THEMELUES  
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“ALFA RROBAQEPESI”SH.P.K**

**Zj.ALDA GJOKA**



**Z.Fred Gjoka**

